

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kafe Shqeto - Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916491/proteste-kunder-blokimit-te-rruges-200-vjecare-banoret-duan-t-na-marrin-jeten-kalaja-fushe-kruja-ndahet-pergjysme/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 08:51:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:27:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7cd2e239b43bfbf34a245590d46d9786c4874f135159d355437dc58e435ec505
TEKSTI	034d0ae55a11082bc507be8e763413fc47af22653f2ad11c6c0f2ffc87f5d5f0
PAMJA	bbfaf4bf8134b45378dc36adada222bae2f93ad6a01604992364d81a18019a4e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c8fabbd99da8617c0e9a9df299b45bc2e8a60a4e7f17d7d419bd36e54f1f534b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c8fabbd99da8617c0e9a9df299b45bc2e8a60a4e7f17d7d419bd36e54f1f534b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

më të lexuarat

Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me firmën

Horoskopi, 13 shtator/ Zbulohet çfarë parashikojnë yjet për secilin shenjë

Këshillat e ekspertëve: 5 gjëra që nuk duhet t'i ndani me ChatGPT

Shqipëria po përballlet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE

Brenda kolapsit të agjencisë së surrogacisë që u kushtoi grave surrogate dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e tyre



Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë

10:27, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Qytetarët kanë dalë në një protestë urgjente në lagjen 'Bakushe Visha' në Fushë-Krujë, duke bllokuar aksin nacional.

Shkaku i kësaj revolte është ndërtimi i rrugës së re, i cili ka sjellë një kaos total dhe ka izoluar tërësisht komunitetin autokton të zones, ku rruga ekzistuese 200-vjeçare e kësaj lagjeje është bllokuar papritur me masive të mëdha betoni.

Nga terreni në një komunikim direkt me emisionin 'Kafe Shqeto' në Syri Tv, kreu i PD Krujë, Aulon Kalaja tha se ky veprim ka lejuar vetëm kalimin e mjeteve të tonazhit të rëndë, duke e kthyer rrugën historike të komunitetit në një rrugë qorre.

Sipas Kalasë, për shkak të këtij projekti, lagja është ndarë përgjysmë, duke pamundësuar komunikimin normal mes vetë banorëve të qytetit.

Qytetarët e indinjuar theksojnë se kjo është një protestë apolitike për të drejtat e tyre më elementare jetësore, ku pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për llogari në bashki, atyre nuk u është vënë në dispozicion projekti dhe ndihen të injoruar totalisht nga qeveritarët.

Banorët e përshkruajnë situatën si një skandal të vërtetë, ndërsa një prej tyre e quajti situatën "për faqe të zezë", si dhe duke deklaruar se ndihen sikur shteti po kërkon t'u marrë jetën.

'Siç e shikoni jemi me banorë të lagjes "Bakushe Visha" në Fushë-Krujë, të cilët kanë dalë për me blloku rrugën kryesore që po ndërton bashkia, dhe protestohet sepse ka krijuar një kaos total. Për shkak se kjo rrugë që ekzistonte para 200 vitesh, pra e shikoni me cilin asfalt... pra rruga e lagjes, bllokohet totalisht. Kanë vendosur këtë masiv betoni dhe nuk ka komunikim njëra lagje me lagjen tjetër. Pra e shikoni, këtu kalojnë makinat e tonazhit të rëndë, mund ta ndjekësh. Dhe këtu tani e kanë bllokuar rrugën dhe është një rrugë qorre, që është shumë e rëndësishme për banorët, mund të flasin edhe vetë banorët, që i ndan këta përgjysmë. Pra kërkohet minimalisht që të vendoset një semafor këtu, duhet një zgjidhje sepse ndahet Fushë-Kruja përgjysmë. Shumë mirë që po bëhet rruga e re. Kjo është një protestë jo politike, është një protestë që këta dalin për të drejtat e veta. Kush janë këta kryetarë bashkish, deputetë, çfarë janë këta qeveritarë që e ndajnë lagjen "Bakushe Visha"?'

e naqja lagjen 'Banorë Viona' : një nga lagjet më të rehatshme të Fushë-Krujës, Fushë-Krujë-formuese kjo lagje. Janë banorë autoktonë, janë banorë të cilët sot janë shumë të indinjuar, kanë kërkuar llogari në bashki dhe nuk iu është dhënë projekti. Dhe me një të rënë të lapsit sot shohin veten që nuk mund të kalojnë këtu. Rrugica e parë e bllokume, rrugica tjetër atje e bllokume, rrugica djathtas që futesh në thellësi të lagjes e bllokuar, dhe nuk ka komunikim. Pra duhet të shkojnë në Luz për me shku në Fushë-Krujë nga ana tjetër sepse s'kanë ku të kthehen', u shpreh Kalaja

'Situata është për faqe të zezë. Këtu duan me na marrë jetën. Se jetën na kanë marrë, po duan me na e heq krejt! Na bllokojnë rrugën 200 vjeçare. Vijnë këta e bllokojnë rrugën... Çfarë t'i bëjmë ne këtij shteti? Si t'ia vemë emrin kësaj pune? Me thënë mirë, s'bëhet, veç me vra veten. Prapë me vra veten se këtu s'kemi ça me bë. Faqja e zezë me të gjitha anët', u shpreh një nga banorët e izoluar si pasojë e bllokimit të rrugës.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Dita e parë e shkollës në Kavajë, kryebashkiaku Fisnik Qosja mesazh urimi për të gjithë nxënësit



Durrës/ Gjimnazi 'Gjergj Kastrioti' i mbyllur prej 7 vitesh! Në Fllakë fëmijët mësim në klasat pa xhama e mes ferrave



Vlonjatët po ikin nga Vlora/ Më pak nxënës në klasën e parë, në bankat e shkollës dhe fëmijë ukrainas

VIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin Bashkiak, opozita: Fondi i emergjencave nuk po përdoret nga mungesa e planifikimit

Sot priten reshje shiu në të gjithë territorin, njihuni me parashikimin e motit dhe sa do të jenë temperaturat

Parashikimi i horoskopit 12 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot

TË NGJASHME



Numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret/ Këtë vit gati 700 më pak në bankat e shkollës



Berati po boshatiset/ Bie ndjeshëm numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, dhe ata që hyjnë në klasën I



Shpopullimi në qarkun e Elbasanit/ Viti i ri shkollor nis me më pak fëmijë në bankat e klasës së parë



Shpopullimi në Gjirokastrë/ Më pak nxënës në klasën I - Në zonat rurale klasa kolektive, ose vetëm me 1 fëmijë



Shpopullimi/ Në qarkun e Fierit më pak nxënës në banka! Shkollat në periferi e ato rurale drejt boshatisjes



E hëna nis me diell e freski – Ja parashikimi i motit për sot



Sot viti i ri shkollor! Mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin, 25 mijë prej tyre ulen për herë të parë në banka

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.